

STATUTI I SHOQERISE
"G-S-SINAKOLI" Sh.p.k.

Ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare", une i nenshkruari shpall si me poshte vijon:

NENI 1
Formimi i shoqerise

Formohet shoqeria e quajtur "G-S-SINAKOLI " Sh.p.k. me ortake te vetem:

1. Z. GENC SINAKOLI, shtetas shqiptar, i biri i Jakupit, i lindur ne Kllojke Tirane me dt: 07. 11. 1981 banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 028753377, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

NENI 2
Selia e Shoqerise

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Tirane Farke MJULL BATHORE Njesia Administrative Farke Zona Kadastrale 1605, Volumi 8, Faqe 119, Nr pasurie 292/42. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 3
Kohezgjatia e veprimtarise ekonomike

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 4
Objekti i veprimtarise se Shoqerise


Importim eksportim, tranzitim, perpunim, transport dhe tregtim me shumice dhe pakice te naftes, gazit, vajrave lubrifikante dhe nenprodukteve te tyre dhe aksesore te ndyshem per automjete .Perpunim , transport, tregtim i naftes dhe gazit etj .Krijimi, shfrytezimi i depove te karburantit te zoteruara teresisht ose te marra me kontrate nga shoqeria. Bar restorant, lavazh, gomisteri. Ndertime civile dhe ekonomike , ndertime civile, industriale turistike, bujqesore deri ne 5 kate. Punime restaurimi, restaurim i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike. Punime karpenterie. Veprimtari ne fushen e konfeksioneve , rrobaqepsi. Punime sherbimi, punime ne sipërfaqe te gjelberta parqe - pyll, lulishtari.

NENI 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj. vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te nise kapitalin si pas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

NENI 6
Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke .
Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:



- 1- Ortaku Themelues Z. GENC SINAKOLI, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100,000 (Njeqind mije) leke qe perben 100% te kapitalit fillestar te shoqerise.

NENI 7

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendim ne te njenjtat kushte qe kerkohen per ndyshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njenjten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 8

Transferimi I kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizur e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegemise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, persa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

NENI 9

Organoi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- d) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe d te kesaj pike
- f) Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit
- i) Pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne precedime te tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese;
- m) Ceshtje te tjera te percaktuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblen e pergjithshme, ne baze ten je autorizimi nga nje ortak tjeter apo nje person I trete.

Administrator I shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne Asamblen e Pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asambles se Pergjithshme, e cila perfshin dhe

mblledhjet vijuese me te njenjtin rend dite.

NENI 10

Menyra e thirrjes se Asambles se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin daten , oren e mblledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mblledhjen e Asambles.

Kur Asambleja nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni ajo mund te marre vendime te vlefshme nese te gjithë ortaket jane dakort per te marre vendime, pavarsisht parregullsise.

NENI 11

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektornike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se Kuorumit te permendur me lart , Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njenjtin rend dite.

NENI 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e Pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne precedime te tjera ndaj administratoreve
- g) Miratimin e rregullave procedurale te mblledhjeve te Asamblese;

Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 13

Perjashtimin nga e drejta e votes

1- Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese Asambleja e Pergjithshme merr vendim per:

- a) Vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
- d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2- Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, I autorizuari vlersohet te jete ne te njenjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 14

Administrimi

Asambleja e pergjithshme emerohet 1 ose me shume persona fizik si administrator te shoqerise. Afati I emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riprertitjeje. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Administratoret e nje shoqerije tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij Ligji nuk mund te emerohen si administrator ten je shoqerije te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim I bere ne kundershkrim me keto dispozita eshte I pavlefshem.

Personi I meposhtem caktohet si administrator I pare I shoqersise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e asamblese se pergjithshme.

- 1- Z. GENC SINAKOLI, shtetas shqiptar, i biri i Jakupit, i lindur ne Killojke Tirane me dt: 07. 11. 1981 banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 028753377.

NENI 15

Kompetencat e Administratorit

Administratoret kane te drejte te detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vensosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) Perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpernadrjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) Krijojne nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- g) Raportojne perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave kombetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e Pergjithshme ne rastet kur

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjeteve financiare, rezulton ose ekziston reziku qe aktivet e shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme Brenda tre muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter active, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria, Brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vleren me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emerohet me shume se nje administrator, ata e administrojen bashkerisht shoqerin.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marrdhenieve kondraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 16

Pergjegjesit e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marrveshjeve te miratuara nga Asambleja qe I sjellin dem shoqerise, I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit per " Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

- a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimi te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) Te ushtroje kompetencat qe I njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- d) Te parandaloje dhe menjanonje rastet e konfliktit present apo te mundshem, te interesave personale me at ate shoqerise;
- e) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori , gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vlersimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirbesim.

Nese administrator vepron ne kundershitim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 te ketij neni eshte I detyruar t'I demshperbleje shoqerise demet, qe rrjdhin nga kryerja e shkeljes si dhe t'I kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administrator ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrato, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Ne menyre te vecante, por pa u kufizur ne to administrator eshte I detyruar t'I demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershitim me dispozitat e ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kryhen veprimet e mepostme:

- a) U kthen ortakeve kontributet;
- b) U paguan ortakeve interesa apo dividente
- c) U shperndan aktivet shoqerise;
- d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare duhet te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe I ngarkohet personalisht administrator, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise, perfshire dhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkes padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

NENI 17 **Viti financiar**

Viti financiar I shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundin me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 18 **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e drejtes vendimore qe ka.



NENI 19
Prishje dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te asamblese se Ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr 9723, dt 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- e) Me vendim te gjyarkes,

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje apo likujdatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe mertesen shtese "Shoqeria ne Likujdim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, Brenda 30 diteve pas prishjes cdo person I interesuar mund t'I drejtohet gjyarkates, per te caktuar nje likujdues.

NENI 20
Riorganizimi I shoqerise bashkimi - ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te mbledhjes se pergjithshme te asambles te ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te ligjit 9901 dt 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 21
Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.


Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

NENI 22
Mosmarrveshjet

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaku i shoqerise "G-S-SINAKOLI" Sh.p.k.

GENC SINAKOLI



Tirane me 13/11/2019